



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"  
ZYRA E MARRËDHENIEVE ME JASHTË DHE KËRKIMIT SHKENCOR

Nr. 169 Prot.

Gjirokastrë, më 08.02.2023

**Lënda:** Hapet thirrja për pjesëmarrje në Programin Erasmus+ me Universitetin e Kretës.

Në kuadër të Programit Erasmus+, Universiteti I Kretës ka fituar një grant për kërkim shkencor dhe trajnim në bashkëpunim me Universitetin e Gjirokastrës.

Sipas Marrëveshjes kërkohet që Universiteti i Gjirokastrës të marrë pjesë me:

**3 pozicione për staff akademik**, të cilët do të angazhohen në mësimdhënie për një periudhë një javore në Universitetin e Kretës.

**3 pozicione për studentë** që do të angazhohen në praktikë mësimore për një periudhë 4-mujore në Universitetin e Kretës.


Planifikimi i aktivitetit mësimor do të zhvillohet gjatë vitit akademik **2022-2023**, semestri i dytë. Gjuha e përdorur do të jetë anglisht në nivelin B2. Sipas marrëveshjes me Universitetin e Kretës, aplikimet janë të hapura për Departamentin e Gjuhës, Letërsisë dhe Civilizimit Grek dhe Departamentin e Shkencave të Edukimit dhe të Metodologjisë së Mësimdhënies.

Nëse jeni të interesuar, lutemi të dërgoni pranë Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë dhe Kërkimit Shkencor, brenda datës **13.02.2023**:

- një letër interesi, në anglisht.
- një CV të detajuar mundësisht në formatin EUROPASS CV në anglisht.
- një provë / certifikatë të njohurive të gjuhës angleze sipas niveleve të specifikuara më sipër.

Dokumentacioni juaj do të vlerësohet paraprakisht nga një komision AD HOC i ngritur pranë UGJ dhe më pas ky vlerësim do t'i përcillet palës së Universitetit të Kretës, për vlerësimin përfundimtar të aplikantëve të cilët do të përzgjidhen.

Prof. dr. Bektash Mema

  
REKTOR

